

 TRAINKOS SH.A.  
TRAINKOS D.D.  
TRAINKOS J.S.C.

Nr.No.Br. 2151

Dt. 30.07.2019

Fushë Kosovë • Fushë Kosova • Kosovo Po"ë



## REGULLORE PËR PROVIZIONIMIN E LLOGARIVE TË ARKËTUESHME

Fushë Kosovë,  
Korrik 2019

Bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Kosovare të Kontabilitetit (SKK) 1.15 dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), Ligjit për tatim në të ardhura (Ligji Nr. 03/L- 162), Ligjit për Shoqëritë Tregtare (Ligji Nr. 06/L-016), Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 03/L-087), Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike (Ligji Nr. 03/L-048), Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës -Trainkos Sh.A. në Mbledhjen nr. 4, të mbajtur më 30.07.2019, miratoi:

## **Rregulloren për Provizionimin e Llogarive të Arkëtueshme**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi**

Departamenti i financave në kuadër të Ndërmarrjes Publike Hekurudhat e Kosovës-Trainkos Sh.A. është përgjegjës për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) si dhe të gjitha procedurave dhe politikave kontabël të aprovuara nga Ndërmarrja.

Përmes kësaj Rregulloreje, Ndërmarrja do të ketë një politikë të shlyerjes në lidhje me kalkulimin e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe një kontrollë më të mirë ndaj kërkesave. Ndërmarrja do të bëjë analiza të rregullta të vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme. Kjo do t'i ndihmojë menaxhmentit që të përmirësojë arkëtimet dhe barazimet me klientët dhe të bëjë vlerësime të sakta për provizione të borxheve të këqija.

### **Neni 2**

#### **Fushëveprimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e procedimit, përlllogaritjes dhe regjistrimit të provizionimeve të llogarive të arkëtueshme.

### **Neni 3**

#### **Përkufizimet**

Të gjitha shprehjet e përdorura në këtë rregullore si më poshtë kanë këto domethënie:

1. SNK - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit;

2. SNRF - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar;
3. SKK – Standardet Kosovare të Kontabilitetit;
4. Llogari të arkëtueshme - të janë të drejtat për shumat e borxhit ndaj ndërmarrjes, blerësve dhe individëve, të krijuar nga shitjet e mallrave dhe shërbimeve me afat pagese (kredit);
5. Borxhet e pa-arkëtueshme - janë borxhe specifike të cilat klientët ia kanë borxh ndërmarrjes dhe për të cilat vendoset se nuk do të paguhet kurrë; si dhe
6. Lejimi për të arkëtueshmet - është një vlerësim i përqindjes së borxheve të cilat priten të mos ripaguhet.

#### **Neni 4**

##### **Borxhet e pa - arkëtueshme**

Borxhet e pa-arkëtueshme janë borxhe specifike të cilat klientët ia kanë borxh ndërmarrjes dhe për të cilat vendoset se nuk do të paguhet kurrë. Ato fshihen nga librat si shpenzime e dërgohen në pasqyrën e të ardhurave.

#### **Neni 5**

##### **Procedura për kategorizimin e borxheve**

Një borxh i keq (ose i pa-arkëtueshëm) do të konsiderohet shpenzim nëse:

- 5.1. Shuma që korrespondon me borxhin, më përpara është përfshirë në të hyra;
- 5.2. Nëse kanë kaluar së paku 6 muaj nga afati i pagesës;
- 5.3. Nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;
- 5.4. Borxhi është çregjistruar në libra si i padobishëm për qëllime kontabiliteti; dhe
- 5.5. Atëherë kur ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit, sikurse janë;
  - 5.5.1. Barazimi i çdo borxhi të pa kontestueshëm kundrejt borxhit të keq,
  - 5.5.2. Atëherë kur korrespondenca dhe kontaktet janë shpenzuar në përpjekje për mbledhjen e borxhit,
  - 5.5.3. Atëherë kur veprimi juridik ka qenë i pasuksesshëm, apo është konsideruar si joekonomik

për arsye të dokumentuara.

## Neni 6

### Lejimet për të arkëtueshme

Lejimi për të arkëtueshmet është një vlerësim i përqindjes së borxheve të cilat priten të mos ripaguhen.


## Neni 7

Lejimet për të arkëtueshmet mund të jenë:

- Lejimet specifike dhe
- Lejimet e përgjithshme

## Neni 8

**Lejimet për të arkëtueshmet specifike** bëhen në pajtim me studimin analitik të secilit klient veç e veç. Regjistrimi bëhet duke ngarkuar llogarinë e shpenzimeve të borxhit të keq dhe duke kredituar llogarinë individuale të klientit.



## Neni 9

**Lejimet për të arkëtueshmet të përgjithshme** bëhen në pajtim me vlerat dhe normat e përgjithshme të arkëtimit. Megjithatë, për shkak të rreziqeve që trashëgon shitja e mallrave me kredi, është e pranueshme se në çdo moment, ka gjasa që një përqindje e caktuar e borxheve të papaguara të mos ketë mundësi të arkëtohet. Por megjithëse mund të vlerësohet se, të themi, deri

në 5% e borxheve do të jenë të pa-arkëtueshme, Ndërmarrja një gjë të tillë nuk do t'ia dijë deri në kohën kur vetë borxhet specifike bëhen të pa-arkëtueshme.

Në kontabilitet regjistrimi bëhet duke ngarkuar llogarinë e lejimeve për të arkëtueshmet dhe duke kredituar llogarinë e lejimeve në këtë mënyrë:

- Në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve regjistrohet shpenzimi; si dhe
- Në bilancin e gjendjes totali i llogarive të arkëtueshme minus lejimet për të arkëtueshmet.

## **Neni 10**

### **Rishikimi i llogarive të arkëtueshme**

Llogaritë e arkëtueshme dhe pagesat do të rishikohen në fund të çdo tre mujori për të siguruar se borxhet e dyshimta janë kontabilizuar në mënyrë adekuate deri në mbylljen e vitit fiskal.

## **Neni 11**

### **Shlyerja e borxheve të këqija**

Autoritetin për shlyerjen e borxheve të këqija e ka Bordi i Drejtorëve pas plotësimit të kriterëve sipas nenit 5 të kësaj rregullore.

## **Neni 12**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi me 01.08.2019.

  
**Ramush AHMETAJ**  
Kryesues i Bordit të HK-Trainkos-SH.A